



**Tel:** +355 4 2269097  
**Fax:**  
**E-Mail:** info@dpa.gov.al

## RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT

**Kodi: DA-RG-002**

**Rishikim nr 5**  
**Dt: 31.03.2023**

**Faqe 1 nga 7**

## RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT

**Zbatuesit:** Anëtarët e Bordit të Akreditimit, Sekretariati i Bordit të Akreditimit.


**Përgjegjësi për zbatim:** Drejtori i Përgjithshëm, Kryetari i Bordit të Akreditimit.

**KONTROLLOI: ZNJ. PRANVERA FAGU**

**MIRATOI: ZNJ. DELINA IBRAHIMAJ**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKREDITIMIT**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

 <p><b>Tel:</b> +355 4 2269097 <b>Fax:</b> <b>E-Mail:</b> info@dpa.gov.al</p>	<b>RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT</b>	<b>Kodi: DA-RG-002</b>
		<b>Rishikim nr 5</b> <b>Dt: 31.03.2023</b>
		<b>Faqe 2 nga 7</b>

## Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat e Bordit të Akreditimit, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Akreditimit, organizimin e tij të brendshëm, thirrjen e mbledhjeve dhe procedurat e vendimmarrjes, konfliktet e mundshme të interesit dhe konfidencialitetin.

## Neni 2 Baza Ligjore

Kjo Rregullore miratohet në përputhje me :

- Ligji Nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.
- ISO/IEC 17011:2017 – Kërkesat për organizmat e akreditimit të cilat kryejnë akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit
- Manuali i Cilësisë i DPA § 3.7.
- Procedura DA-PM-008 “Aktivitetet e reja të akreditimit, vlerësimi i skemave të konformitetit dhe tranzicionet drejt standardeve”.
- Procedura DA-PM-005 “Procedura e ankesave dhe apeli meve”.
- Procedura DA-PM-019 “Procedura e menaxhimit të riskut”.
- Procedura DA-PM-018 “Procedura e monitorimit të vendimmarrësve”.

## Neni 3 Fjalori dhe Shkurtime

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit : DPA  
Bordi i Akreditimit : BA

## Neni 4 Fusha e zbatimit dhe përgjegjësitë

4.1 Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë anëtarët e BA për të gjithë fushën e veprimtarisë së BA.

4.2 Drejtori i Përgjithshëm i DPA ka përgjegjësi të kontrollojë zbatimin e kësaj rregulloreje.

## Neni 5 Misioni i Bordit të Akreditimit

BA është një organ i përhershëm i strukturës së DPA -së, në të cilin përfaqësohen të gjitha palët e interesuara. Ngritja dhe përbërja e tij derivon nga nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat e standardit ISO/IEC 17011:2017 dhe dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të DPA.



**Tel:** +355 4 2269097  
**Fax:**  
**E-Mail:** info@dpa.gov.al

## RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT

**Kodi: DA-RG-002**

**Rishikim nr 5  
Dt: 31.03.2023**

**Faqe 3 nga 7**

### Neni 6

#### Përbërja dhe Struktura e Bordit të Akreditimit


6.1 BA ka 16 anëtarë. Përfaqësimi i tyre është i balancuar dhe me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara dhe përbëhet nga:

- 6 përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Ekonominë e Tregtinë, Bujqësinë dhe Ushqimin, Çështjet e Mjedisit, Ndërtimin, Sigurinë e Shëndetit dhe të Jetës në Punë;
- 2 përfaqësues nga Organet e Vlerësimit të Konformitetit të Akredituara;
- përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve;
- 1 përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- 2 përfaqësues nga Organizatat e Biznesit;
- 2 përfaqësues nga Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorëve;
- 2 përfaqësues nga Institucionet Shkencore.

6.2 BA funksionon në bazë të rregullores, që miratohet nga ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë. Në rregullore përcaktohen edhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve, si dhe mënyra e organizimit të bordit. Masa e shpërblimit për anëtarët e bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Përbërja nominative e anëtarëve të bordit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për tregtinë.

Pala e interesuar	Përfaqësimi
6 përfaqësues nga Ministritë përgjegjëse	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe të Ekonomisë të jetë përgjegjës për çështjet e ekonomisë</li><li>Një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe të Ekonomisë të jetë përgjegjës për shëndetin në punë</li><li>Një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë,</li><li>Një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe të Punës Sociale.</li><li>Një përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Industrisë.</li><li>Një përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</li></ul>
2 përfaqësues nga Organizatat e biznesit	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë</li><li>Një përfaqësues i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë</li></ul>
2 përfaqësues nga Institucionet shkencore	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit</li><li>Një përfaqësues nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës</li></ul>
1 përfaqësues nga organizmi i metrologjisë	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë</li></ul>
1 përfaqësues nga organizmi i standardeve	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit</li></ul>
Pala e interesuar	Përfaqësimi
2 përfaqësues nga shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit	<ul style="list-style-type: none"><li>Një përfaqësues i Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit</li><li>Një përfaqësues i Shoqatës së Konsumatorëve Shqiptare</li></ul>
2 përfaqësues zgjidhen nga organet e vlerësimit të konformitetit të akredituara	

Në rast të marrjeve të vendimeve të brendshme për efekt të punës së BA, cdo palë e interesuar në BA

 <p><b>Tel:</b> +355 4 2269097 <b>Fax:</b> <b>E-Mail:</b> info@dpa.gov.al</p>	<b>RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT</b>	<b>Kodi: DA-RG-002</b>
		<b>Rishikim nr 5 Dt: 31.03.2023</b>
		<b>Faqe 4 nga 7</b>

ka pjesëmarrje në votim me një votë.

## Neni 7 Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Akreditimit


BA ka ekskluzivisht rol këshillues dhe jep rekomandime në lidhje me:

- Hartimin e strategjisë dhe politikës kombëtare të akreditimit.
- Zhvillimin e sistemit kombëtar të akreditimit bazuar në legjislacionin shqiptar për akreditimin të fushave të ndryshme të veprimtarisë.
- Strategjinë dhe politikën e akreditimit kombëtar në shoqërinë shqiptare për të arritur aprovim dhe mbështetje të gjerë.
- Projekte të ndryshme për zhvillimin e akreditimit.
- Trajtimin e ankesave dhe apelimeve si edhe dhënien e rekomandimeve Drejtorit të Përgjithshëm të DPA-së në lidhje me ankimin apo apelimin.
- Trajtimin e skemave të reja të vlerësimit të konformitetit dhe skemave të akreditimit që i përcillen, për dhënie sugjerimesh ose rekomandimesh Drejtorit të Përgjithshëm në zbatim të procedurës DA- PM- 008.
- Çështjet e ngritura nga institucionet qeveritare brenda kompetencave të BA.
- Krijimin e një sistemi akreditimi të denjë për të gjitha fushat në Shqipëri.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të performancës duke ju përgjigjur në kohë dhe cilësi kërkesave për progres.
- Përcaktimin dhe rishikimin e rrugëve për realizimin e misionit dhe vizionit të DPA-së.
- Monitorimin e performancës dhe kompetencës së vendimmarrësve

## Neni 8 Kriteret për anëtarët e Bordit të Akreditimit

**8.1** Në zbatim të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, DPA përcakton kriteret e mëposhtme për përzgjedhjen e anëtarëve të BA, të cilat miratohen nga Ministri përgjegjës për ekonominë:

- Të përfaqësojnë një nga palët e interesuara, Ministrinë, Organet e Akredituara, Ekspertë të përfshirë në aktivitetet e vlerësimit të konformitetit dhe në procesin e akreditimit.
- Të njohë legjislacionin aktual në lidhje me akreditimin, dhe/ose fushave të lidhura me akreditimin.
- Të ketë përvojë pune të paktën 3 (tre) vjeçare, në organizmin që do të përfaqësojë në BA.
- Të njohë rolin e Infrastrukturës së Cilësisë në përgjithësi dhe të vlerësimit të konformitetit në veçanti.
- Pozicioni aktual i punës të ketë lidhje me zhvillimin e akreditimit në fushat përkatëse ose me zhvillimin e akreditimit në Shqipëri. Detyrat e tyre duhet të lidhen me akreditimin, vlerësimin e konformitetit, mbikqyrjen e tregut ose me infrastrukturën e cilësisë në përgjithësi
- Të njohë parimet dhe procedurat e akreditimit.
- Të jenë të aftë të punojnë në grup.

 <p><b>Tel:</b> +355 4 2269097 <b>Fax:</b> <b>E-Mail:</b> info@dpa.gov.al</p>	<b>RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT</b>	<b>Kodi: DA-RG-002</b>
		<b>Rishikim nr 5 Dt: 31.03.2023</b>
		<b>Faqe 5 nga 7</b>

- Të mbajnë pozicione të rëndësishme në krijimin e politikave në organizmat që përfaqësojnë.
- Përbën përparësi nëse kandidati ka punuar më parë në cilësinë e vlerësuesit teknik.

**8.2** Cdo palë e interesuar propozon kandidatin e mundshëm për anëtar BA pas kërkesës së DPA. Anëtarët e BA miratohen nga Ministri përgjegjës për tregtinë, për një periudhë 3 (tre) vjeçare, pas një verifikimi të përputhshmërisë me kriteret për anëtarët nga Drejtori i Përgjithshëm DPA-së.

**8.3** Çdo nominim zotëron një vlefshmëri mandati 3 (tre) vjeçar, në fundin e të cilit kërkohet ri-konfirmimi ose zëvendësimi.

**8.4** Çdo palë e interesuar mund të rishikojë nominimin përkatës dhe të promovojë zëvendësimin e përfaqësuesit të tij gjatë mandatit. Përfaqësuesi zëvendësues qëndron deri në fund të periudhës së mandatit tre vjeçar të përfaqësuesit të zëvendësuar, duke u ri-konfirmuar apo zëvendësuar në fund të tij. Zëvendësimi bëhet me të njëjtën procedurë të konfirmimit të anëtarëve të BA bazuar në kriteret e specifikuar në pikën 8 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 9 Funksionimi**

**9.1** Kryetari dhe nënkryetari i BA zgjidhet nga anëtarët e BA me votim të hapur dhe me shumicë të thjeshtë, jo më vonë se në mbledhjen e dytë të BA. Specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit kryen rolin e Sekretariatit të BA.

**9.1.1** Mbledhjet e BA thërriten me kerkese të Drejtorit të Përgjithshëm të DPA, të Kryetarit të BA ose me kërkesën me shkrim nga së paku 50% e anëtarëve. Prania e së paku 50% +1 të anëtarëve të BA dhe të paktën e një përfaqësuesi nga çdo palë e interesuar do të përbëjë një kuorum.

**9.1.2** Kryetari i BA ka funksionet e mëposhtme:


- a- Drejton të gjitha mbledhjet e BA.
- b- Koordinon me sekretariatit e BA për axhendën e mbledhjeve të BA.
- c- Thërret mbledhjet sipas kërkesës për rastet e veçanta/jashtëzakonshme.

**9.1.3** Kryetari vendos mbi oraret dhe çështjet për diskutim në mbledhjen e ardhshme duke informuar anëtarët e BA nëpërmjet sekretariatit të BA.

**9.2** Mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të BA thirren nga Kryetari. Bordi zhvillon të paktën katër mbledhje në vit. Mbledhjet e jashtëzakonshme kërkojnë prezencën e 2/3 të numrit të anëtarëve dhe të paktën e një përfaqësuesi nga çdo palë e interesuar. Mbledhjet e tjera të zakonshme apo të jashtëzakonshme mbahen në formë komunikimi interaktiv/elektronik, si për dokumentacionin ashtu edhe për votimin.

**9.2.1** Sekretariati i BA i dërgon pjesëmarrësve të paktën 10 ditë para takimit, axhenden e mbledhjes dhe materialet e nevojshme. Në rastin e materialeve voluminoze, ato i ofrohen anëtarëve në zyrën e sekretariatit të BA ose i dërgohen në rrugë elektronike. Anëtarët e BA janë të detyruar të njoftojnë në lidhje me pjesëmarrjen apo mos pjesëmarrjen e tyre 48 orë para datës së zhvillimit të mbledhjes.

Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet zyrtarisht dhe në rrugë elektronike dhe duhet të tregojë qartësisht dhe me detaje çështjet të cilat do të diskutohen.

 <p><b>Tel:</b> +355 4 2269097 <b>Fax:</b> <b>E-Mail:</b> info@dpa.gov.al</p>	<b>RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT</b>	<b>Kodi: DA-RG-002</b>
		<b>Rishikim nr 5 Dt: 31.03.2023</b>
		<b>Faqe 6 nga 7</b>

**9.2.2** Axhenda miratohet në fillim të mbledhjes. Gjatë mbledhjes, është i mundur zgjerimi i axhendës nëse janë dakort më shumë se gjysma e pjesëmarrësve.

**9.3** Për të analizuar apo diskutuar çështje specifike, mund të thërriten apo të ftohen anëtarë të përkohshëm/ekspertë/vlerësues apo punonjës të DPA-së me kërkesë të Kryetarit të BA dhe miratim nga një e treta (1/3) e anëtarëve.

**9.4** Drejtori i Përgjithshëm DPA-së merr pjesë në mbledhjet e BA jo me cilësinë e anëtarit të bordit.

**9.4.1** Drejtori i Përgjithshëm prezanton një raport mbi aktivitetin dhe të dhënat e përgjithshme, si një strategji për të ardhmen në mbledhjen e parë të çdo viti.

**9.4.2** Drejtori i Përgjithshëm informon BA-në lidhur me rezultatet e rishikimeve të menaxhimit, auditimet e brendshme dhe vlerësimet e jashtme të kryera nga EA. BA informohet gjithashtu rreth aktivitetit të grupeve teknike të punës, skemave të akreditimit, procedurave dhe rregulloreve të akreditimit.

**9.4.3** Në rastin e shqyrtimit të BA mbi skemat e reja, përgatitet një raport paraprak nga Sekretariati i BA, ku të prezantohen të gjitha fazat në të cilat kanë kaluar këto skema.

**9.5** Në rast mungese në mbledhjet e BA për arsye të justifikueshme, anëtarët informojnë sekretariatit e BA, duke dhënë mendimet/sugjerimet/komentet personale lidhur me problemet që do të diskutohen në mbledhjen e radhës. Sekretariati i BA kontrollon pjesëmarrjen e anëtarëve të bordit, duke marrë për bazë që 2 (dy) mungesa të njëpasnjëshme të pajustificueshme të një anëtari përbëjnë një tregues të mungesës së interesit për punën e BA, duke konsideruar një zëvendësim të tij. Ky zëvendësim bëhet në të njëjtën procedurë të konfirmimit të anëtarëve të BA, bazuar në kriteret e specifikuar në pikën 8 të kësaj rregulloreje.

**9.6** Rekomandimet dhe dokumentet e tjerë do të miratohen me shumicë të thjeshtë votash nga çdo palë e pranishme.


**9.6.1** BA përgatit një raport vjetor të punës së bordit i cili i dërgohet Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të DPA-së. Raporti vjetor përgatitet çdo fundviti dhe jo me vonë se muaji mars i vitit pasardhës. Raporti vjetor hartohet nga një grup pune i përbërë nga tre anëtarë të bordit të cilët caktohen nga kryetari. Raporti vjetor i bordit miratohet nga kryetari i bordit.

**9.7** Sekretariati i BA njofton anëtarët për datën e mbledhjes, përgatit materialet dhe konkluzionet e mbledhjes. Raporti i mbledhjes mbahet nga sekretariati i BA.

**9.7.1** Procesverbalet mbahen në të gjitha mbledhjet, dhe regjistrohen rekomandimet e bëra. Regjistrimet përgatiten nga Sekretariati i BA dhe arkivohen në arkivin e DPA-së. Procesverbalet miratohen në mbledhjen e ardhshme. Procesverbalet e miratuara nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e Bordit BA.

**9.7.2** Çdo mbledhje mbahet e regjistruar. Rregjistrimet përbëhen nga thirrja për mbledhje, kërkesa për mbledhje, axhenda, procesverbalet e mbledhjes, pjesëmarrësit etj. Mbledhjet e BA zhvillohen në ambientet e DPA-së.

**9.7.3** Për kryerjen e detyrave të caktuara BA mund të vendosë për ngritjen e një komiteti/grupi të përhershëm ose të përkohshëm, duke përcaktuar detyrat e tij. Komiteti/grupi mund të ftojë ekspertë të jashtëm. Ekspertët e jashtëm kanë gjithashtu detyrimin e konfidencialitetit dhe të

 <p><b>Tel:</b> +355 4 2269097 <b>Fax:</b> <b>E-Mail:</b> info@dpa.gov.al</p>	<b>RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT</b>	<b>Kodi: DA-RG-002</b>
		<b>Rishikim nr 5</b> <b>Dt: 31.03.2023</b>
		<b>Faqe 7 nga 7</b>

deklarimit të konfliktit të interesave. Komiteti/grupi kryesohet nga kryetari i tij i cili ka detyrimin të raportojë tek BA për veprimtarinë e komitetit/grupit.

## Neni 10 Konfidencialiteti dhe Paanshmëria

**10.1** Anëtarët e BA dhe pjesëmarrësit e ftuar nga BA janë të detyruar të ruajnë konfidencial çdo informacion të marrë gjatë aktivitetit të tyre si anëtar të bordit. Çdo anëtar i BA dhe cdo pjesëmarrës i ftuar nga BA nënshkruan Deklaratën e konfidencialitetit, paanshmërisë dhe konfliktit të interesave sipas formës DA-FO-010.

**10.2** Çdo anëtar i BA ka detyrimin të informojë sekretariatit e BA dhe Kryetarit e BA për çdo konflikt interesi të mundshëm familjar, tregtar, financiar dhe cdo konflikt tjetër në lidhje me çështjet që do të diskutohen në BA. Anëtarët e BA duhet të deklarojnë paraprakisht në rast se ndodhen në konflikt interesi.

Në rast konflikti interesi, anëtari i BA nuk përfshihet gjatë procesit të adresimit të rastit në fjalë. Anëtarit nuk i vihet në dispozicion dokumentacioni apo raportet për procedurën specifike. Ai/ajo largohet nga salla e mbledhjes gjatë diskutimeve dhe gjatë votimeve për marrjen e vendimeve që i përkasin rastit në fjalë.

## Neni 11 Konfirmimi nga Bordi i Akreditimit.

Pasi u konsultua nga anëtarët e BA u ra dakord t'i rekomandohet titullarit të Ministrisë përgjegjëse për tregtinë miratimi i kësaj rregulloreje.



**Tel:** +355 4 2269097  
**Fax:**  
**E-Mail:** info@dpa.gov.al

## RREGULLORE E BORDIT TË AKREDITIMIT

**Kodi: DA-RG-002**

**Rishikim nr 5**  
**Dt: 31.03.2023**

**Faqe 8 nga 7**

### Historiku

<b>Data e Rishikimit</b>	<b>Numri i rishikimit</b>	<b>Hartoi</b>	<b>Përshkrimi i ndryshimeve</b>
30.06.2006	0	Ardita Mele	Varianti fillestar
17.03.2011	1	Arben Isaku	Janë bërë ndryshime sipas Ligjit nr. 9824 datë 01/11/2007 dhe VKM nr. 1716 datë 03/10/2008, në pikat: 6. Termat e referencës; 7. Përbërja dhe Struktura; 8. Kriteret për anëtarët e BKA; 9. Funkionimi; 10. Konfidencialiteti dhe Paanshmëria.
27.07.2015	2	Suela Kromidha	Janë bërë ndryshime në pikën 4,5, 7 dhe është hequr pika 9.2, 9.2.1, 9.4.1, 9.4.2, 9.6, 9.6.1, 9.7, 9.7.1, 9.7.3, 10.1, 10.2, 10.3, 10.4, në zbatim të Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe është shtuar funksioni i nënkryetarit të BA pika 9.1 si dhe është shtuar pika 12.
18.07.2017	3	Ardita Mele	Ndryshime në pikat 9.1.1 dhe 9.2 në lidhje me prezencën e anëtarëve të bordit në mbledhje.
12.02.2018	4	Rexhina Lati	Ndryshime në pikat 7 në lidhje me përfaqësuesit e anëtarëve të bordit nga Ministrit përgjegjëse . Termi MZHETS zevendesohet me Ministri përgjegjës për ekonominë . Si pasojë e ndryshimit të emrit të ministrisë.
18.01.2023	5	Ardita Mele Brikena Hasa Suela Kromidha	Ndryshime ne pikat 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10 dhe 11.